



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



National Endowment for Democracy
Supporting freedom around the world

PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR KËRCËNIMET E REJA TË EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NË KOSOVË

SHKURT 2019



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR
KËRCËNIMET E REJA TË
EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM
NË KOSOVË

Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)

Autore: Vesë Kelmendi, hulumtuese

Rishikimi i brendshëm: Mentor Vrajolli & Skender Perteshi

Redaktore: Rudinë Jakupi, hulumtuese

Përkrahur nga: National Endowment for Democracy (NED)

Dizajni: Arbër Matoshi

© Të gjitha të drejtat të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Ligji mbi të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Ndërlidhura mbron të drejtat dhe pronën intelektuale.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem të ritërheqjes ose të transmetohet, në asnjë formë a në çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik ose tjetër, pa lejen me shkrim nga botuesi. Përdorimi komercial i të gjitha medieve të publikuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) nuk lejohet pa pëlqimin me shkrim të QKSS. Ju lutemi kontaktoni: info@qkss.org ose +381 38 221 420.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e informacionit të mbledhur nga të anketuarit dhe ai vetëm tregon se si njerëzit i perceptojnë institucionet. Ky nuk është aspak vlerësim përfundimtar për cilësinë e punës së institucioneve në këtë studim. Ai do t'u shërbejë atyre si instrument për t'i adresuar mangësitë e mundshme, por edhe si tregues i efektivitetit të komunikimit të tyre me njerëzit.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë perceptimet e të anketuarve dhe nuk përfaqësojnë domosdo pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë. Opinionet e shprehura në këtë raport nuk paraqesin detyrimisht pikëpamjet e National Endowment for Democracy (NED).

PËRMBAJTJA

HYRJE	7
GJETJET KRYESORE:	8
KAPITULLI 1 - PERCEPTIMET MBI KËRCËNIMET E SHFAQURA NGA EKSTREMIZMI I DHUNSHËM I MOTIVUAR ETNIKISHT, POLITIKISHT DHE FETARISHT	9
1.1 PERCEPTIMI I QYTETARËVE MBI PËRPARIMIN E BËRË PËR KUNDËRSHTIMIN DHE PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM (K/PEDH) NË KOSOVË	12
KAPITULLI 2 - A KANË NDRYSHUAR PERCEPTIMET E KOMUNITETIT PËR LUFTËTARËT E HUAJ TË KTHYER?	15
2.1 PËRGJIGJA E KOMUNITETIT NDAJ LUFTËTARËVE TË KTHYER MESHKUJ QË IU BASHKUAN KONFLIKTIT NË SIRI DHE IRAK	17
2.2 PËRGJIGJA E KOMUNITETIT NDAJ GRAVE DHE FËMIJËVE TË KTHYER QË IU BASHKUAN KONFLIKTIT NË SIRI DHE IRAK	18
KAPITULLI 3 - BESIMI NDAJ AKTORËVE KRYESORË TË PËRFSHIRË NË PROGRAMET PEDH	21
METODOLOGJIA - Ç'ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?	24

AKRONIMET

LEDh	Kundërshtimi i ekstremizmit të dhunshëm
LHT	Luftëtar i Huaj Terrorist
ISIS	Shteti Islamik I Irakut dhe Sirisë
BKS	Barometri Kosovar i Sigurisë
PEDh	Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm

HYRJE

Ky edicion special i Barometrit Kosovar të Sigurisë (BKS) mbi ekstremizmin e dhunshëm më 2018 tërheq vëmendjen në faktin se qytetarët e Kosovës ende besojnë që luftëtarët e kthyer të huaj janë shqetësime për sigurinë për shkak të aftësive të tyre luftarake dhe lidhjeve të tyre me grupet terroriste.¹ Për ta kuptuar ndikimin e komunitetit në përpjekjet e rehabilitimit, është me rëndësi jetike që të njihen perceptimet për ekstremizmin e dhunshëm (EDh) pasi çdo komunitet ka nevojat, ngjashmëritë dhe dallimet. Më shumë se gjysma e të anketuarve nuk do të pranonin ish-luftëtarët e huaj në komunitetin e tyre. Nëse në vitin 2017, shumica dërrmuese e të anketuarve përkrahnin programet e parandalimit dhe rehabilitimit nga Qeveria e Kosovës për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm, 2 në vitin 2018, janë 48 përqind të të intervistuarve që konsiderojnë se institucionet e Kosovës duhet të përqendrohen më shumë në programet e parandalimit, sepse situata është e njëjtë dhe nuk vërehen ndryshime në këtë drejtim.

Raporti përbëhet nga analiza e të dhënave mbi perceptimet lidhur me kërcënimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe besimin ndaj aktorëve të përfshirë në parandalimin e këtij fenomeni. Ai ndahet në tri seksione kryesore: i pari përqendrohet në perceptimet e përgjithshme rreth ekstremizmit të dhunshëm dhe formave të tjera të ekstremizmit, si: dhuna e motivuar etnikisht, dhuna politike dhe dhuna e motivuar fetarisht; i dyti përshkruan perceptimet ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve të luftëtarëve të kthyer, si dhe gatishmërinë e komunitetit për të pranuar ish-luftëtarët e huaj dhe gra/fëmijë; seksioni i fundit fokusohet në perceptimet ndaj aktorëve të përfshirë në zbatimin e strategjisë të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë.

1 Perteshi, S (2018) "Beyond the triggers: new threats of violent extremism in Kosovo" http://www.qkss.org/repository/docs/violent-extremism-eng_611603.pdf

2 Kelmendi, V (2017) "Perceptimet e qytetarëve dhe reagimi i komunitetit për luftëtarët e huaj të kthyer" [http://www.qkss.org/repository/docs/perceptimet-eng_\(1\)_933130.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/perceptimet-eng_(1)_933130.pdf)

GJETJET KRYESORE:

Gjetjet kryesore të këtij edicioni të BKS lidhur me perceptimin e qytetarëve mbi kërcënimin që vjen nga ekstremizmi i dhunshëm janë:

- Të gjeturat e raportit tregojnë se krahasuar me vitet e mëparshme, kërcënimi i perceptuar nga ekstremizmi i dhunshëm është ulur për 5 përqind;
- Më 2018, 70 për qind e të anketuarve besojnë se ekstremizmi i dhunshëm është një kërcënim kombëtar për Kosovën;
- Rreth gjysma e të anketuarve pajtohen se individët e radikalizuar vazhdojnë të përhapin ekstremizmin e dhunshëm në Kosovë;
- 37 përqind e të anketuarve konsiderojnë se institucionet e Kosovës po e adresojnë fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm, ndërsa 30 përqind e të anketuarve besojnë se institucionet e Kosovës duhet të përqendrohen më shumë në këtë çështje;
- Në kontekstin rajonal, shumica e të anketuarve nga komunat Gjilan dhe Ferizaj (40 përqind) konsiderojnë se institucionet e Kosovës janë më të përgjegjshme për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.
- Të anketuarit nga Prishtina dhe Gjakova (30 përqind) kanë perceptime të ulëta mbi punën e institucioneve të Kosovës për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm;
- Më se gjysma e të anketuarve nuk do t'i pranonin luftëtarët e huaj të kthyer (LHT) në komunitetin e tyre;
- Në krahasim me burrat e anketuar, gratë e anketuara i konsiderojnë burrat e kthyer nga konflikti si rrezik më të madh për sigurinë e vendit;
- Të anketuarit shprehën qëndrime pozitive ndaj grave dhe të miturve të kthyer nga zonat e konfliktit.

Gjetjet kryesore të identifikuara nga ky botim i BKS lidhur me perceptimin e qytetarëve sa u përket aktorëve janë si vijon:

- Besimi i qytetarëve në organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet fetare rezultoi më i lartë sesa në Qeverinë, Kuvendin, Gjykatat, Prokurorinë dhe Komunitetin;
- Qytetarët kanë besim më të ulët ndaj mediave, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në përhapjen e kundër-mesazheve ndaj rrëfimeve të ekstremizmit të dhunshëm;
- Shumica e të anketuarve përdorin televizionet private si burim kryesor informacioni;
- Pothuajse gjysma e të anketuarve nga Mitrovica e Veriut përdorin platforma mediatike online për t'u informuar;
- 56 përqind e praktikuesve muslimanë kanë besim ndaj Bashkësisë Islame, ndërsa 76 përqind e të anketuarve katolikë ndanin besimin ndaj Kishës Katolike në Kosovë.

PERCEPTIME TË PËRGJITHSHME MBI EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM 2018:

Perceptimet mbi kërcënimet e shfaqura nga ekstremizmi i dhunshëm i motivuar etnikisht, politikisht dhe fetarisht

Gjatë viteve të kaluara, EDh është parë si kërcënim i konsiderueshëm prej qytetarëve të Kosovës. Rezultatet e vitit 2017 tregojnë se 74 përqind e të anketuarve e konsiderojnë këtë fenomen si kërcënim. Megjithatë, rezultatet gjatë këtij viti tregojnë se përqindja e atyre që e konsiderojnë ekstremizmin e dhunshëm si kërcënim ka rënë pak. Përkatesisht, vetëm 70 përqind të anketuarve e konsideronin atë si kërcënim. Vetëm 13 përqind e të anketuarve pohuan se ekstremizmi i dhunës nuk është kërcënim për vendin.




Figura 1 Perceptime të Përgjithshme mbi Ekstremizmin e Dhunshëm 2018

Këtu duhet theksuar megjithatë se, ndonëse qytetarët e Kosovës nuk e zhvlerësojnë kërcënimin potencial që paraqet EDh, rezultatet e tjera tregojnë se janë të vetëdijshëm edhe se ky fenomen nuk është kërcënimi më i madh me të cilin përballet Kosova. Për shembull, të anketuarit konsiderojnë fenomenet si krimi i organizuar, polarizmi politik, tensionet mes Kosovës dhe Serbisë më të rrezikshme se ekstremizmi i dhunshëm.³ Megjithatë, ky raport fokusohet vetëm në perceptimin e qytetarëve ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

Gjetjet e BKS tregojnë se qytetarët kanë pikëpamje të ndryshme lidhur me kërcënimin e ekstremizmit të dhunshëm në varësi të burimit që shkakton këtë kërcënim, siç është dhuna e motivuar etnikisht, politikisht dhe fetarisht.

Rezultatet treguan se 41 përqind e të anketuarve konsideronin si kërcënim ekstremizmin e dhunshëm të motivuar politikisht, ndërsa 30 përqind e të anketuarve deklaruan se ekstremizmi i dhunshëm i motivuar kombëtarisht/etnikisht është kërcënim ndaj sigurisë kombëtare dhe rreth 23 përqind e të anketuarve deklaruan dhunën me bazë fetare si rrezik shtetëror.

3 Marku. D (2018) Barometri Kosovar i Sigurisë, botimi 8 http://www.qkss.org/repository/docs/barometri2018-eng2_477654.pdf




Figura 2 Perceptimi i qytetarëve naj formave të ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm si: etnik, politik dhe fetar

Rezultati sivjet është në linjë edhe me botimet e mëparshme të BKS që vazhdimisht e rendisnin dhunën me motive fetare si kërcënim më të vogël krahasuar me dy format e tjera të ekstremizmit të dhunshëm.⁴ Perceptimet e tilla bazohen kryesisht në zhvillimet e përgjithshme politike që kanë karakterizuar Kosovën gjatë viteve të fundit, marrëdhëniet e tensionuara midis qeverisë dhe opozitës nga njëra anë dhe mosmarrëveshjeve politike midis Kosovës dhe Serbisë nga ana tjetër, duke përfshirë vështirësitë për të vënë kontrollin institucional në komunat e Kosovës me shumicë serbe në pjesën veriore.⁵ Sidoqoftë, rezultati nuk duhet të nënvlerësojë kërcënimin që vjen nga ekstremizmi i dhunshëm, sidomos duke pasur parasysh se kohët e fundit ka pasur raportime për përpjekjet terroriste të motivuara fetarisht, por që janë parandaluar me sukses nga Policia e Kosovës.⁶

4 Kelmendi, V (2017) "Perceptimet e qytetarëve dhe reagimi i komunitetit për luftëtarët e huaj të kthyer" [http://www.qkss.org/repository/docs/perceptimet-eng_\(1\)_933130.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/perceptimet-eng_(1)_933130.pdf)

5 Fokusgrupi me hulumtuesit në terren 2018 (Data: 09 nëntor 2018)

6 Gazeta Zëri "Si po përgatitej sulmi terrorist vetëvrases kundër ushtarëve të KFOR-it në Kosovë", 09 qershor 2018 Gjetet në: <http://zeri.info/kronika/202299/si-po-pergatitej-sulmi-terrorist-vetevrases-kunder-ushtareve-te-kfor-it-ne-kosove/>

Perceptimi ndaj kërcënimit të paraqitur nga pikëpamja etnike, politike dhe fetare është analizuar edhe nga këndvështrimet rajonale, etnike dhe gjinore. Nga këndvështrimi rajonal, të anketuarit nga Mitrovica (veri) i konsideronin të gjitha këto burime ekstremizmi më shumë si kërcënim sesa ata nga zonat e tjera.




Figura 3 Perceptimi i qytetarëve mbi format e ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm siç janë: etnikisht, politikisht dhe fetarisht të motivuara

Perceptimet publike me bazë gjinore mbi format e ekstremizmit të dhunshëm tregojnë se shumica e grave, ose 42 përqind e grave të intervistuar, e konsiderojnë dhunën e motivuar politikisht si rrezik kryesor, krahasuar me 41 përqind të të anketuarve meshkuj. Tridhjetë e dy përqind e grave të anketuara e konsiderojnë dhunën e motivuar etnikisht si rrezik në krahasim me 28 përqind të të anketuarve meshkuj që ndanin të njëjtat pikëpamje. Në përgjithësi, burrat dhe gratë e konsiderojnë dhunën e motivuar fetarisht si rrezik më të ulët.




Figura 4 Perceptimet gjinore mbi format e ekstremizmit të dhunshëm siç janë: etnikisht, politikisht dhe fetarisht të motivuara

Nga këndvështrimi etnik, rezultatet sërish treguan se të anketuarit serbë ishin më të predispozuar ta konsideronin dhunën e motivuar etnikisht si rrezik në krahasim me të anketuarit shqiptarë, të cilët e konsiderojnë dhunën e motivuar politikisht si rrezik kryesor për ekstremizmin e dhunshëm. Sidoqoftë, marzha e dallimit mes shqiptarëve dhe serbëve në këtë rast është perceptimi i tyre ndaj dhunës së motivuar fetarisht. Për shembull, 50 përqind e të anketuarve shqiptarë e shohin dhunën e motivuar fetarisht si rrezik të ulët, në krahasim me 10 përqind e të anketuarve serbë që e shohin dhunën e motivuar fetarisht si rrezik të ulët për vendin.




Figura 5 Perceptimet etnike mbi rreziqet që vijnë nga ekstremizmi i dhunshëm siç janë: etnikisht, politikisht dhe fetarisht të motivuara

1.1 Perceptimi i qytetarëve mbi përparimin e bërë për kundërshtimin dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm (K/PEDh) në Kosovë

Në Kosovë, problemi i ekstremizmit të dhunshëm deri më tash është trajtuar kryesisht me qëllim të parandalimit të këtij fenomeni (PEDh). Që nga miratimi i Strategjisë Kombëtare të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që shpie në terrorizëm 2015-2015, si dhe Planit të Veprimit, aktivitetet kryesisht janë fokusuar në përfshirjen e komunitetit për ngritjen e vetëdijes mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe zhvillimin e platformave kreative për të rinjtë në nivel lokal. Megjithatë, në dy vitet e fundit, Qeveria e Kosovës ka zhvendosur agjendën nga PEDh për t'u fokusuar kryesisht në luftëtarët e kthyer dhe të pakthyer nga Siria dhe Iraku. Lidhur me programet që përqendrohen në rehabilitimin e LHT-ve të kthyer në 2018, Qeveria e Kosovës ka krijuar divizionin e riintegritit të luftëtarëve të kthyer të huaj dhe të familjarëve të tyre. Ky program do të zbatohet me mbështetjen e ICITAP në kuadër të Ministrisë së Brendshme.⁷ Divizioni ka filluar të zbatojë disa aktivitete të cilat janë të fokusuar tek të kthyerit, si dhe familjarët e luftëtarëve të huaj.

Megjithatë, pyetjes: "A ka ende individë që vazhdojnë të përhapin ekstremizmin e dhunshëm në Kosovë" qytetarët i përgjigjen se besojnë që ka dëshmi se individët e radikalizuar ende po rekrutojnë njerëz nga komuniteti për ta mbështetur ideologjinë e tyre. Për shembull, 52 për qind e të anketuarve u pajtuan se individët e radikalizuar po i ndikojnë të tjerët që t'i mbështesin grupet terroriste, ndërsa 20 për qind e të anketuarve konsiderojnë se nuk ka përpjekje që individët e radikalizuar të vazhdojnë të përhapin ekstremizmin e dhunshëm. Vetëm 21 për qind konsiderojnë se individët e radikalizuar po vazhdojnë të përhapin ekstremizmin e dhunshëm në komunitetin e tyre deri në njëfarë mase.




Figura 6: Perceptimet e qytetarëve: "A ka ende individë që vazhdojnë të përhapin ekstremizmin e dhunshëm në Kosovë"

Anketa e BKS 2018 i ka pyetur të anketuarit edhe nëse pajtohen se situata e sotme lidhur me ekstremizmin e dhunshëm ka ndryshuar, si dhe nëse masat e ndërmarra nga institucionet e Kosovës kanë dhënë rezultate pozitive. Në rastin e parë, 48 për qind e të anketuarve besojnë se situata e lidhur me ekstremizmin e dhunshëm mbetet e njëjtë me vitet paraprake, krahasuar me 26 të të anketuarve që nuk pajtohen me këtë vlerësim. Në rastin e dytë, 37 për qind e të anketuarve konsiderojnë se institucionet e Kosovës po e adresojnë fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm, ndërsa 30 për qind e të anketuarve nuk pajtohen me këtë vlerësim.

⁷ Telegrafi "MPB themelon njesi per deradikalizimin e personave qe jane ne lufterat e huaja" 2018, Gjendet në: <https://telegrafi.com/mpb-themelon-njesi-per-deradikalizimin-e-personave-qe-jane-ne-lufterat-e-huaja/>




Figura 7 Perceptimet e qytetarëve ndaj situatës së ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë 2018

Përgjigjet janë ndarë edhe në bazë të nivelit rajonal. Në grafikun e mëposhtëm mund të shihet se të anketuarit nga Gjilani dhe Ferizaji pajtoheshin se institucionet e Kosovës janë përqendruar në çështje të lidhura me ekstremizmin e dhunshëm, krahasuar me rajonet si Prishtina dhe Mitrovica, ku të anketuarit konsiderojnë se Qeveria e Kosovës nuk ka bërë shumë në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.



Figura 8 Perceptimet rajonale mbi institucionet e Kosovës në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm sipas Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Kosovë

Nga ana tjetër, shumica e qytetarëve nga të gjitha rajonet besojnë se situata lidhur me fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm është e njëjtë dhe se pothuajse asgjë nuk është përmirësuar. Pesëdhjetë e katër përqind e të anketuarve nga Peja, Mitrovica e Gjilani konsiderojnë se situata me ekstremizmin e dhunshëm është e njëjtë sot dhe asgjë nuk ka ndryshuar në krahasim me të anketuarit nga Prizreni, Mitrovica e Veriut, Prishtina dhe Gjakova që ndajnë të njëjtat pikëpamje.



Figura 9 Situata e ekstremizmit të dhunshëm në bazë të rajoneve të Kosovës




Figura 10 Perceptimet gjinore ndaj institucioneve të Kosovës në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm sipas Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Kosovë

A KANË NDRYSHUAR PERCEPTIMET E KOMUNITETIT PËR LUFTËTARËT E HUAJ TË KTHYER?

Kjo pjesë e raportit adreson këto pyetje dhe perceptime të (i) rreziqeve nga ish-luftëtarët e kthyer (ii) gatishmërisë së komunitetit për t'i pranuar luftëtarët meshkuj të kthyer, si dhe gratë e të miturit në komunitetin e tyre. Të dhënat janë kategorizuar sipas gjinisë, zonave dhe rajoneve. Rezultatet tregojnë se ka mungesë të gatishmërisë nga komunitetet e Kosovës për t'i pranuar ish-luftëtarët e kthyer dhe për t'i riintegruar në nivel lokal. Statistikisht, vetëm 65 përqind e të anketuarve pohuan se këta individë paraqesin rrezik për sigurinë kombëtare dhe vetëm 16 përqind shtuan çfarëdo rreziku të paraqitur nga të kthyerit.




Figura 11 Perceptimi i qytetarëve ndaj luftëtarëve të huaj si rrezik sigurie më 2018




Figura 12 Perceptimi i qytetarëve ndaj luftëtarëve të huaj si rrezik i sigurisë ndan zonat rurale/urbane

Një tjetër vërtetim interesant i ofruar ndaj rreziqeve të paraqitura nga luftëtarët e kthyer të huaj janë perceptimet e ndryshme të ndara sipas gjinisë. Shumica ose 68 përqind e të anketuarve gra mendojnë se ish-luftëtarët e kthyer nga Siria dhe Iraku, përbëjnë kërcënim real për sigurinë kombëtare krahasuar me 60 përqind të të anketuarve burra që ndajnë këto vlerësime. Vetëm 20 përqind e të anketuarve burra deklaruan se ish-luftëtarët e kthyer nuk paraqesin rrezik për Kosovën, ndërsa 12 përqind e grave të anketuara mbanin të njëjtin qëndrim. Rrjedhimisht, institucionet e Kosovës duhet të përfshijnë më shumë gra mbi çështjet e sigurisë, si dhe duhet fuqizuar rolin e grave në mekanizmat formalë dhe joformalë për ta parandaluar ekstremizmin e dhunshëm. Kjo shihet qartë edhe në Strategjinë Kombëtare për parandalimin e ekstremizmit të dhunës, ku gratë përmenden vetëm një herë, në fund të Strategjisë.⁸

8 Strategjia për parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm 2015-2020 http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGY_parandalim_-_ENG.pdf




Figura 13 Perceptimet gjinore ndaj LHT-ve të kthyer si rrezik sigurie

Të dhënat e bazuara në rajone tregojnë se shumica e rajoneve i konsiderojnë ish-luftëtarët e kthyer si rrezik kryesor për sigurinë kombëtare. Për shembull, 71 për qind e të anketuarve nga Mitrovica e Veriut besojnë se këta individë paraqesin rrezik për vendin, krahasuar me të anketuarit nga Prizreni, Peja dhe Gjakova që ndanin të njëjtat vlerësime për ish-luftëtarët e kthyer.




Figura 14 Perceptimet e qytetarëve të ndara sipas rajoneve kundrejt LHT-ve të kthyer si rrezik sigurie

2.1 Përgjigja e komunitetit ndaj luftëtarëve të kthyer meshkuj që iu bashkuan konfliktit në Siri dhe Irak

Raporti i fundit “Shpjegimi i dallimit: Cenueshmëria dhe Qëndrueshmëria ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm në Kosovë” konkludoi se programet efektive parandaluese duhet kryesisht të përqendrohen në kapacitetet lokale dhe ndërtimin e partneriteteve për PEDh dhe qëndrueshmërinë e komunitetit ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Në veçanti, të dhënat e paraqitura në këtë raport konfirmojnë se është e domosdoshme të identifikohen faktorët që i bëjnë komunitetet të ndjeshme ose të qëndrueshme ndaj ekstremizmit të dhunshëm.⁹ Për këtë qëllim, është shumë me rëndësi të analizohen perceptimet e qytetarëve të Kosovës për të kuptuar nëse do t’i pranonin luftëtarët e kthyer në komunitetin e tyre. Perceptime të tilla na ndihmojnë të kuptojmë se si institucionet, shoqëria civile dhe komuniteti i donatorëve duhet të përqendrohen në nismat lokale bashkarisht me komunitetet.

Të dhënat e mbledhura tregojnë se 53 përqind e të anketuarve nuk do të pranonin ish-luftëtarët të kthyer në komunitetin e tyre, ndërsa 28 përqind e të anketuarve konsiderojnë se do t’i pranonin këta individë me kusht që të vendoseshin nën mbikëqyrjen e rendit dhe ligjit. Në anën tjetër, 12 përqind e të anketuarve thanë se nuk kishin fare problem me praninë e tyre në komunitet. Sipas të anketuarve, ish-luftëtarët meshkuj paraqesin rrezik më të lartë, pasi kanë qenë drejtpërsëdrejti në fushën e betejës.




Figura 15 Perceptimet e komunitetit mbi pranimin e LHT-ve në lagje

Të dhënat e BKS-së tregojnë edhe se varësisht nga sfondi, komunitetet në Kosovë pak a shumë ngurrojnë t’i pranojnë ish-luftëtarët e huaj në komunitet. Për këtë qëllim, e analizuam këtë rezultat edhe në bazë të perspektivës rurale/urbane dhe asaj rajonale. Të dhënat tregojnë se respondentët ruralë ngurronin më shumë t’i pranonin LHT-të krahasuar me ata urbanë.




Figura 16 Gatishmëria e qytetarëve për t’i pranuar luftëtarët e kthyer meshkuj sipas zonave (rurale/urbane)

⁹ Rudine Jakupi & Garentina Kraja “Accounting for the Difference: Vulnerability and Resilience to Violent Extremism in Kosovo”, October 2018, http://www.qkss.org/repository/docs/CTR_CaseStudy3_kosovo_ENG_574166.pdf

Shumica e komuniteteve në Kosovë kanë shprehur mendimet e tyre për luftëtarët burra, në shumicën e rajoneve të Kosovës deklaruan se nuk do t'i pranonin ata në lagje.




Figura 17 Gatishmëria e qytetarëve për t'i pranuar luftëtarët e kthyer meshkuj sipas rajoneve

Perceptimet në bazë të gjinisë ndaj luftëtarëve burra tregojnë se 57 përqind e grave të anketuara nuk do t'i pranonin ish-luftëtarët në komunitet, krahasuar me 49 të të anketuarve burra që kishin të njëjtin vlerësim mbi LHT-të e kthyer.




Figura 18 Perceptimet gjinore për pranimin e luftëtarëve të kthyer në lagje

2.2 Përgjigja e komunitetit ndaj grave dhe fëmijëve të kthyer që iu bashkuan konfliktit në Siri dhe Irak

Përveç LHT-ve, të anketuarit u pyetën edhe nëse janë të gatshëm t'i pranojnë gratë e kthyer dhe fëmijët në komunitetin e tyre. Figura e mëposhtme tregon se në këtë rast të anketuarit ndanin qëndrime më pozitive krahasuar me luftëtarët e kthyer burra në Kosovë. Sipas të anketuarve, gratë dhe fëmijët kryesisht janë detyruar dhe kërcënuar nga bashkëshorti ose babai për të marrë vendimin për t'u bashkuar në zonën e konfliktit. Prandaj, 36 përqind e të anketuarve deklaruan se do t'i pranonin gratë e kthyer dhe të miturit në komunitet, ndërsa 28 përqind të tjerë deklaruan se do t'i pranonin nëse do të mbikqyreshin nga institucionet shtetërore. Megjithatë, edhe në këtë rast rreth 30 përqind e të anketuarve deklaruan se nuk do t'i pranonin gratë dhe fëmijët në komunitet, që është përqindje shumë e lartë.




Figura 19 Perceptimet e komunitetit për pranimin e grave dhe të miturve në komunitet

Megjithatë, është me rëndësi të maten perceptimet e qytetarëve lidhur me kategorinë e grave dhe fëmijëve të kthyer nga aspekti rajonal, sepse komuniteti mund të luajë rol tejet pozitiv në programet për rehabilitimin e tyre. Bazuar në perspektivat e komunave të Kosovës, deri në 40 për qind e të anketuarve deklaruan se do t'i pranoinin gratë dhe fëmijët në komunitetin e tyre, krahasuar me 59 për qind e të anketuarve që thanë se nuk do t'i pranoinin luftëtarët meshkuj në komunitet. Për shembull, Ferizaji (43 për qind) dhe Gjakova (41 për qind) ishin më të hapur ndaj grave dhe të miturve në krahasim me luftëtarët meshkuj të huaj. Sipas të anketuarve nga komuna e Prizrenit, ata nuk do të pranoinin luftëtarë meshkuj në komunitet. Në shumicën e rajoneve kishte perceptime pozitive për të pranuar luftëtarë meshkuj në komunitetin e tyre nën mbikëqyrjen e autoriteteve shtetërore. Për shembull, 30 përqind e të anketuarve nga Mitrovica e Veriut do t'i pranoinin luftëtarët meshkuj në komunitet nën mbikëqyrjen e shtetit.




Figura 20 Perceptimi i rajoneve për të pranuar gratë dhe të miturit në komunitet

Të dhënat e mbledhura tregojnë se njëra nga sfidat kryesore të përpjekjeve për riintegrimin e luftëtarëve të huaj të kthyer është të rritet vetëdijesimi mbi rëndësinë dhe përgjegjësinë e institucioneve dhe shoqërisë për të ndihmuar në rehabilitimin e të kthyerve nga Siria dhe Iraku. Statistikat tregojnë se shumica e grave dhe fëmijëve janë ende në zonat ose kampet e konfliktit, por duan të kthehen në Kosovë. Për më shumë, hulumtimet e fundit sugjerojnë se gratë dhe të miturit luajnë rol të rëndësishëm në përçimin e ideologjisë dhe trashëgimisë së IS edhe pas rënies fizike të të ashtuquajturit 'Kalifat'.¹⁰




Figura 22 Perceptimet gjinore për t'i pranuar gratë dhe të miturit e kthyer në komunitet




Figura 21 Perceptimet e qytetarëve sipas zonave rurale/urbane për t'i pranuar gratë/të miturit e kthyer në komunitet

¹⁰ Cook, Joana and Gina Vale. 2018. "From Daesh to 'Diaspora': Tracing the Women and Minors of Islamic State." International Centre for the Study and Radicalization (ICSR), Department of War Studies, King's College, p.3. 2018. <https://icsr.info/wp-content/uploads/2018/07/ICSR-Report-From-Daesh-to-%E2%80%98Diaspora%E2%80%99-Tracing-the-Women-and-Minors-of-Islamic-State.pdf>

BESIMI NDAJ AKTORËVE KRYESORË TË PËRFSHIRË NË PROGRAMET PEDH

Në këtë pjesë të raportit janë paraqitur të dhënat lidhur me besimin në aktorët kryesorë të përfshirë në programet PEDh: (i) *institucionet në nivel qendror dhe lokal* (ii) *organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet fetare* (iii) *mediat*. Bashkëndimi i aktiviteteve ndërmjet institucioneve qeveritare përgjegjëse, bashkësive fetare, komunitetit në përgjithësi, mediave si dhe bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë do të mundësojë adresimin e problemeve të identifikuar që lidhen me radikalizimin nëpërmjet masave parandaluese.¹¹ Prandaj, ka masa të veçanta siç janë programet për ngritjen e kapaciteteve, hartimi i një plani strategjik për komunikim, rritja e vetëdijesimit në komunitet, si dhe qëllimi i rritjes së bashkëpunimit ndërmjet institucioneve qendrore dhe komunave.¹² Siç specifikohet në edicionin e të përgjithshëm të [BKS 2018](#) besimi ndaj institucioneve qendrore, lokale dhe gjyqësorit ka qenë shumë i ulët, ndërkohë që besimi ndaj institucioneve të sigurisë rezultoi shumë më i lartë. Sidoqoftë, aktorë tjerë që luajnë rol vendimtar sidomos për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm e që nuk përmenden në raportin e lartpërmendur janë shoqëria civile, organizatat fetare dhe mediat.

Rezultati i këtij botimi të BKS tregon se besimi i qytetarëve ndaj këtyre institucioneve është më i lartë krahasuar me institucionet qeveritare dhe gjyqësorin, por më i ulët në krahasim me ato të sigurisë. Përkatesisht, 55 për qind e të anketuarve rezultuan se kanë besim në institucionet fetare, pasuar nga 49 për qind e të anketuarve që i besonin organizatave të shoqërisë civile në Kosovë. Me 29 përqind, të anketuarit u besojnë mediave, rezultat ky dukshëm më i ulët.




Figura 23 Besimi i qytetarëve ndaj Shoqërisë Civile, Medias dhe Institucioneve Fetare

Shumica ose deri në 50 për qind e të anketuarve nga Mitrovica, Gjakova dhe Ferizaji kanë besim në Organizatat e Shoqërisë Civile në Kosovë ndërsa të anketuarit nga Prishtina dhe Gjilani duket se kanë besim më të ulët krahasuar me këto tri komuna. Perceptimet ndaj mediave tregojnë se të anketuarit nga rajonet e Mitrovicës, Gjilanit dhe Prizrenit kanë më shumë besim në krahasim me komunat e tjera, si Prishtina, Peja dhe Gjakova që kanë besim më të ulët.

¹¹ Strategjia për parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm 2015-2020 http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGY_parandalim_-_ENG.pdf

¹² Po aty.

Të anketuarit nga rajoni i Gjilanit dhe Mitrovicës ishin ata dukej se kishin më shumë besim ndaj institucioneve fetare krahasuar me komunat e tjera. Për shembull, vetëm 34 përqind e të anketuarve nga Mitrovica e Veriut kanë besim në institucionet e tyre fetare.




Figura 24 Besimi i qytetarëve në shoqërinë civile, mediat dhe institucionet fetare sipas komunave

Të anketuarit që u përkasin feve muslimane dhe katolike kanë më shumë besim ndaj institucioneve fetare krahasuar me të anketuarit që i përkasin fesë ortodokse. Pesëdhjetë e shtatë përqind e praktikuesve muslimanë kanë besim ndaj Bashkësisë Islame, ndërsa 76 përqind e të anketuarve katolikë ndajnë atë besim ndaj Kishës Katolike në Kosovë. Ndërkohë, 43 përqind e praktikuesve ortodoksë kanë besim në Kishën Ortodokse.





Figura 25 Besimi ndaj institucioneve fetare i ndarë: praktikuesit muslimanë, praktikuesit katolikë dhe praktikuesit ortodoksë

Për t'u informuar çdo ditë, qytetarët e Kosovës përdorin kryesisht *Televizionin Publik, televizionet private, mediat online, gazetat ose statusin e miqve në mediat sociale*. Figura e mëposhtme tregon se 44 përqind e të anketuarve informohen nga televizionet private të Kosovës, ndërsa 22 përqind e qytetarëve përdorin televizionin publik si burim informacioni. Vetëm 19 përqind e të anketuarve përdorin platforma të mediave sociale si burim informacioni.



Të dhënat e ndara sipas rajoneve tregojnë se shumica e të anketuarve informohen nga televizionet private (KTV, Klan Kosova, RTV21, etj.), ndërsa të anketuarit nga Ferizaji informohen më shumë nga Televizioni Publik i Kosovës (RTK). Shumica e të anketuarve nga Mitrovica e Veriut informohen nga platformat e mediave online. Të dhënat e tilla mund të na shërbejnë si udhërrëfyes se ku duhet të përqendrohen më shumë institucionet dhe komuniteti i donatorëve për fuqizimin e rolit të medias në LEDh, për t'u përdorur si mjet kryesor për narrativat mbi grupet ekstremiste në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Figura 26 Cilat media i përdorin qytetarët si burim kryesor informacioni




Figura 27 Cilat media i përdorin qytetarët si burim kryesor të informacionit sipas komunave

METODOLOGJIA

Ç'ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?

Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) është program i veçantë i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), i themeluar në shtator 2012. Fokusi kryesor i tij është të masë besimin e publikut kundrejt sigurisë, drejtësisë dhe institucioneve qendrore në Kosovë, si dhe të masë perceptimin e qytetarëve për kërcënimet e brendshme dhe të jashtme të sigurisë që i shfaqen Kosovës. BKS është ndërmarrja e parë dhe më e madhe e këtij lloji, e projektuar, e zbatuar dhe e komunikuar nga një *think tank* lokal në Kosovë. Veçantia e BKS-së në Kosovë është neutraliteti i saj politik. Si *think tank* i pavarur, QKSS nuk ka kufizime politike për të komunikuar cilëndo nga gjetjet dhe mesazhet e anketës. BKS është kombinim i metodave sasiore dhe cilësore që ofrojnë rezultate objektive dhe të besueshme. Të dhënat e tij mblidhen nëpërmjet intervistave ballë për ballë me të anketuar rastësorë që i kryejnë hulumtuesit e QKSS në terren nëpër gjithë Kosovën. Pyetësi i BKS-së kryesisht përbëhet nga pyetje të mbyllura në formë të shkallës pesëpikëshe të Likertit, të pasuar nga disa pyetje të hapura që u japin të anketuarve mundësi për t'i shprehur mendimet pa opsione të paracaktuara.

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

316.48(496.51)(048)

Kelmendi, Vesë

Citizens Perceptions on new threats of violent extremism in Kosovo /
Vesë Kelmendi. – Prishtinë :KCSS, 2019. - 28 f. : ilustr. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-679-89-3

www.qkss.org

ISBN 978-9951-679-89-3



9 789951 679893